



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 20, datë 27.10.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin tetor, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:06

Data e mbajtjes së mbledhjes : 27.10.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje !

Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare! Të nderuar të Pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin tetor.

Siç jeni vënë në dijeni nëpërmjet postës elektronike për rendin e ditës, në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Ftoj sekretaren e këshillit të bëj prezencën në sallë.

**Dorina Milja:** Përshëndetje! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...mungon.

Kryetar ke 35 këshilltarë në sallë.

*p.s. (hyn me vonesë gjatë leximit të rendit të ditës këshilltari A. Ramohitaj), pra 36 këshilltarë.*

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës. Sot për shqyrtim e miratim kemi 18 pika projektvendime për shqyrtim e miratim dhe 1 pikë informim.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN TETOR 2022
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË APARATIT TË BASHKISË SË DURRËSIT
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË BASHKISË DURRËS
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.158 , DATË 23.12.2021, “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2022 DHE PROJEKTBUXHETIT AFATMESËM TË BASHKISË DURRËS PËR VITET 2022-2024, TË NDRYSHUAR
5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 6 000 000 (GJASHTË MILION) LEKË PËR FAMILJET, QË PËRFITOJNË NGA BONUSI I STREHIMIT NË BAZË TË VKB-SË NR. 158, DATË 23.12.2021 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2022, SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFAT MESËM 2022-2024
6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2 165 523 (DY MILION E NJËQIND E GJASHTËDHJETË E PESËMIJË E PESËQIND E NJËZET E TRE) LEKË PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT EUSAIR 4 YOUTH
7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” I NDRYSHUAR

Pika 8. Shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR EMERGJENCAT CIVILE QË I ËSHTË ALOKUAR BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2022.
Pika 9. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5, RRUGA "DAVID SELENICA", PALLATI NR.18, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.
Pika 10. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 6, SUKTH, KATUND I RI DHE ISHËM, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.
Pika 11. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT KRYETARIT TË BASHKISË PËR STUDIMIN DHE PARAQITJEN E MODELIT TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT BUIJQËSOR NË TOKAT PRONËSI SHTETËRORE OSE NË BASHKËPUNIM ME FERMERËT PRIVATË
Pika 12. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR.15, DATË 22.02.2021, "PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË DHJETË ME SUBJEKTET PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, I NDRYSHUAR
Pika 13.shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR.55, DATË 26.06.2020, "PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË PARË ME 6257 SUBJEKTE PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE OSE TË BANESAVE NË NDËRTESA (PALLATE), TË CILAT JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE TË PABANUESHME OSE TË DËMTUARA RËNDË APO TË DËMTUARA LEHTË DHE QË NUK DUHEN RINDËRTUAR NGA E PARA, POR KANË NEVOJË PËR PUNIM RIKONSTRUKSIONI OSE RIPARIME, SI PASOJË E DËMTIMEVE NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, I NDRYSHUAR.
Pika 14. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR.64 , DATË 07.07.2020, "PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE, SIPAS LISTËS SË DYTË TË SUBJEKTEVE PËRFITUES TË PROGRAMIT TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE OSE TË BANESAVE NË NDËRTESA (PALLATE), TË CILAT JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE TË PABANUESHME OSE TË DËMTUARA RËNDË APO TË DËMTUARA LEHTË DHE QË NUK DUHEN RINDËRTUAR NGA E PARA, POR

	KANË NEVOJË PËR PUNIM RIKONSTRUKSIONI OSE RIPARIME, SI PASOJË E DËMTIMEVE NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, I NDRYSHUAR
Pika 15. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E AKTMARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET SPONSORIZUESIT SUBJEKTIT “DULE” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA DURRËS, PËR RIKONSTRUKSIONIN E QENDRËS SHËNDETËSORE SHKAFANE (KURATEN), NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS
Pika 16. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË RINDËRTIMIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 597, DATË 14.9.2022 “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN E PLANIFIKUAR PËR RINDËRTIM, SIPAS PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E DËMTUAR PIKËSORE PËR 5 BANESA KOLEKTIVE, NË BASHKINË DURRËS”
Pika 17. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit 2 komisione të këshillit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT
Pika 18. shtesë Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DRAFT MARRËVESHJES SË BASHKË-INVESTIMIT NDËRMJET FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BASHKISË DURRËS ME OBJEKT: "PËR PROJEKTIMIN NDËRTIMIN DHE MENAXHIMIN E PARKIMIT MULTIFUNKSIONAL PRANË STACIONIT TË TRENIT, DURRËS”
Pika 19. Informim i këshilltarëve	RAPORTIM PËR SEZONIN TURISTIK NË DURRËS, 2022

Atëherë përse i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve?

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj.Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Faleminderit! Mirëdita të gjithëve!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe konfirmon dakortësinë me projektvendimin e dorëzuar nga bashkia. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj :** Ju faleminderit Kryetar.

Komisioni ynë vendosi pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës sotme. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit znj. Bardhaj.

Atëherë komente përsa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

**Artion Beqiraj :** Mundem .

**Ani Dyrmishi :** Po.

**Artion Beqiraj :** Në lidhje me pikën 2 doja të dija me ndryshimet, në lidhje me çfarë kuptimi ka në këtë rast ndryshime niveli, pra : Sa rriten ato ? Çfarë ndryshimi ka ?

Unë personalisht nuk jam i mendimit që pagat duhet të jenë të ulëta apo të larta se e shof në aspektin e dy ekstremeve , por duhet të jenë dinjitoze.

Keni kërkuar këtë ndryshim. Sa është ? Që të shmanget dhe një diskutim që vjen mbi pagat.

**Emiriana Sako:** Valbona mund të japësh një përgjigje.

**Valbona Qirjako (Drejtoresh e Buxhetit) :** Përshëndetje.

Rritja që është bërë është thjesht indeksimi i pagave 7 % që ka dal tashti me vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e pagave në njësitë e vetëqeverisjes vendore” . Për njësitë e qeverisjes vendore për administratën rritja e pagës është thjesht indeksim, është 7 % dhe kjo është aplikuar mbi nivelet e mëparshme të pagave sipas çdo kategorie të nënpunësit civil.

Pra thjesht është indeksim.

**Artion Beqiraj :** Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Po, faleminderit.

Atëherë komente të tjera ka? Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Edhe për këtë pikë komisioni ynë është pro. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj.Bardhaj

Komente përsa i përket pikës 3, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Me shumicë votash komisioni ynë vendosi pro pikës 4. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka, atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....Nuk ka

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5** i japim fjalën znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Edhe për këtë pikë komisioni ynë vendosi pro me shumicë votash. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini** : Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike votoi unanimisht pro përdorimit të këtij fondi prej 6 milion lekësh.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 5, kemi nga ana e këshilltarëve ?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë miratohet me 36 vota pro pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6** fjalën e ka znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Edhe për këtë pikë komisioni ynë vendosi pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Politikave të Zhvillimit të Turizmit z. Artion Beqiraj

**Artion Beqiraj** : Edhe për pikën 6 jemi dakort që të kaloj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 6, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 7**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Përshëndetje.

Komisioni ynë pasi mori në shqyrtim pikën 7, propozon unanimsht për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini**: Edhe Komisioni ynë votoi unanimsht për miratimin e këtyre ndryshimeve.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Dhamo.

**Ana Dhamo**: Përshëndetje.

Edhe Komisioni ynë vendosi ta kaloj këtë pikë për votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 7, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 8** i japim fjalën znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Komisioni Buxhetit vendosi pro miratimit të pikës 8. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë z. Bakaj.

**Afrim Bakaj** : Komisioni Emergjencave Civile ra dakort që kjo pikë të futët për miratim në mbledhjen e këshillit bashkiak.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 8, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 9**, i japim fjalën znj.Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim dhe pikën 9, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Znj. Budini.

**Etleva Budini**: Gjithashtu dhe Komisioni ynë vendosi unanimisht për ta kaluar sot për votim.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit .

Znj. Dhamo.

**Ana Dhamo**: Edhe Komisioni ynë vendosi për ta kaluar.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.



Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 10**, i japim fjalën znj.Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe Komisioni ynë vendosi unanimsisht për miratimin e kësaj liste përfituesish.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .

Znj. Dhamo.

**Ana Dhamo:** Edhe Komisioni ynë propozon për ta kaluar në votim

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 10, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 11**, i japim fjalën Komisionit Rregullore dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Unanimsisht propozojmë për ta kaluar pikën 11 në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe Komisioni ynë votoi unanimsisht për ta kaluar sot

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Përsa i përket pikës 11, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

**Artion Beqiraj :** Mundem .

**Ani Dyrmishi** : Po, z. Beqiraj.

**Artion Beqiraj** : Lexova materialin e pikës 11 duket shumë ambicioz si nisëm, nëse kryetarja do të kishte diçka për të shpjeguar rreth kësaj, duke patur parasysh se bëhet fjalë për zona rurale për ta marrë informacionin më mirë përmes kryetares se duket shumë interesant.

**Emiriana Sako** : Po, faleminderit.

Është një iniciativë në fakt duke marrë shkas dhe nga prioriteti që i është dhënë nga ana e qeverisë shqiptare në mbështetje të fermerëve. Ne po punojmë me dy programe paralel .

Së pari me ngritjen e një strukture të posaçme që mund të jetë sh.a ose shoqatë, ku bashkia do të bashkohet me fermerët, të cilët janë aktiv për të paraqitur interesat e tyre, për të patur mundësinë për të aplikuar në skemat e granteve po edhe për të qënë si suport, si institucion që do të mbështesi gjithë nevojat e tyre. Me këtë miratim në këshill më tej do të fillojmë dhe me dëgjesat publike për të dëgjuar shqetësimet dhe problemet që kanë në këtë sektor, por do të shërbej dhe si një institucionalizim i punës së tyre dhe mbështetje më tej përsa i takon skemave të grantit.

Paralel me këtë “Ne” kemi hartuar dhe një projekt, të cilin e kemi prezantuar në qeverinë shqiptare. Është një projekt për të ndërtuar pika grumbullimi, depozitim dhe frigorifer, që do të përdoren nga fermerët dhe ata që operojnë në këtë sektor. Presim që të marrim një konfirmim pasi pronësia nuk është e bashkisë, por është një pronësi shtet dhe ndodhet pranë projektit të madh, mastërplanit që kemi me portin e ri të Porto Romanos. Pra është një investim që duhet të harmonizohet me këtë mastërplan. Me marrjen e përgjigjes nga institucionet do të vijojmë pastaj me hapat e tjera, hartimi i projektit të zbatimit, sepse është në fazën e projekt-idesë dhe më tej aplikimi. Këto do t’i shërbejnë tërësisht komunitetit të fermerëve dhe nëpërmjet kësaj shoqërie, kësaj shoqate që do të ngremë, do të kemi mundësinë që bashkia të ketë një rol minimal, pra të ketë një përqindje minimale dhe pjesën maksimale të drejtimit të këtij entiteti të jetë në dorën e fermerëve për të paraqitur dhe interesat e tyre. Kjo është ideja e përgjithshme e këtij autorizimi. Ne pas kësaj do të fillojmë me procedurat përkatëse pastaj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komente të tjera ka? Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 11 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 12**, i japim fjalën znj.Rroshi.

**Alneida Rroshi**: Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim pikën 12, propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe Komisioni ynë pasi shqyrtoi dokumentacionin të vënë në dispozicion nga stafi i bashkisë vendosëm unanimitisht për ta kaluar sot në votim në mbledhje.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .  
Znj. Dhamo.

**Ana Dhamo:** Edhe Komisioni ynë vendosi për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.  
Komente përsa i përket kësaj pike, kemi nga ana e këshilltarëve?  
Komente nuk ka, kalojmë në votim.  
Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës?  
Kundra?....  
Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 12 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 13**, i japim fjalën znj.Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim dhe pikën 13 të rendit të ditës, propozojmë për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.  
Znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe Komisioni ynë e votoi unanimitisht për ta kaluar sot.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit .  
Znj. Dhamo.

**Ana Dhamo:** Edhe Komisioni ynë vendosi për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.  
Komente përsa i përket pikës 13, kemi nga ana e këshilltarëve?  
Komente nuk ka, kalojmë në votim.  
Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës?  
Kundra?....  
Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 13 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 14**, i japim fjalën znj.Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim pikën 14, propozon unanimitisht për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.  
Znj. Budini.

**Etleva Budini:** Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike votoi pro miratimit të këtij ndryshimi.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.  
Znj. Dhamo.

**Ana Dhamo:** Edhe Komisioni ynë vendosi për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.  
Përsa i përket pikës 14, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?  
Komente nuk ka, kalojmë në votim.  
Kush është pro miratimit të pikës 14 të rendit të ditës?  
Kundra?....  
Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 14 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 15**, i japim fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Mullaraj.

**Alfred Mullaraj:** Komisioni është dakort për këtë pikë.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit z. Mullaraj.  
Komente përsa i përket pikës 15, kemi nga ana e këshilltarëve?  
Komente nuk ka, kalojmë në votim.  
Kush është pro miratimit të pikës 15 të rendit të ditës?  
Kundra?....  
Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 15 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 16** i japim fjalën znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj :** Komisioni ynë është pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.  
Znj. Dhamo.

**Ana Dhamo:** Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës është dakort dhe vendosi ta kaloj këtë pikë në mbledhjen e sotme të këshillit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 16 të rendit të ditës, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 16 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 16 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 17**, i japim fjalën znj.Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim kërkesën drejtuar këshillit bashkiak në lidhje me pikën 17 në komunikim dhe bashkëpunim me Komisionin e Strehimit propozon që kjo praktikë të miratohet në lidhje me kategorizimin e drejtë të qytetarëve dhe propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Znj. Budini.

**Etleva Budini:** Gjithashtu dhe komisioni ynë vendosi unanimisht për miratimin dhe kalimin në votim sot në këshill bashkiak.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 17, kemi nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 17?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 35 vota pro miratohet dhe pika 17 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 18**, i japim fjalën znj.Rroshi.

**Alneida Rroshi:** Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim pikën 18, propozon për ta kaluar në votim.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Znj. Budini.

**Etleva Budini:** Edhe Komisioni ynë votoi pro miratimit të këtij bashkëinvestimi.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Znj. Dhamo.

**Ana Dhamo**: Edhe Komisioni ynë votoi pro për ta kaluar në votim në mbledhjen e sotme të këshillit bashkiak.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Z. Mullaraj

**Alfred Mullaraj**: Edhe Komisioni jonë është dakort.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Znj. Bardhaj.

**Pamela Bardhaj** : Komisioni Buxhetit është pro.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.  
Atëherë kemi ndonjë koment përse i përket pikës 18, nga ana e këshilltarëve?

**Adriana Hatellari** : Kam unë dy pyetje se nuk jam e qartë.

**Ani Dyrmishi** : Po.

**Adriana Hatellari** : Për pikën 18 kam nja 2 pyetje. Në radhë të parë e vlerësoj shumë si iniciativë, që të krijohen disa pika parkimi për qytetin e Durrësit. Por për këtë që do të bëhet ke treni vjetër, ke stacioni trenit të vjetër kam nja 2 pyetje. Dua të di se nuk jam shumë e qartë, dua të di pronë e kujt është ai territor ku do ndërtohet godina multifunksionale?

Pyetja e dytë , mesa dimë Ne aty ka një plan për zhvendosjen e stacionit të trenit diku tjetër dhe duhet të jetë ky plani madh rregullues. E ka marrë parasysh bashkia dhe këtë detaj që të jetë kjo strukturë pjesë e këtij plani rregullues, jo rregullues, por plani i zhvendosjes së trenit një, dhe aty ka një vit që diskutohet për projektin arab. A prish punë kjo ndërtesë multifunksionale të ndërtuar në këtë pozicion me planin e marinës?

Dhe ajo që kam merak për çdo gjë e mirë që është bërë, duhet të ketë një kosto. Vlerën e investimit do ta paguaj bashkia? Dhe kur të ndërtohet ky objekt : A do fitojmë “Ne” si qytetarë? Cili do të jetë përfitimi ynë? Si do të ndahen të ardhurat që fitohen nga kjo ndërtesë multifunksionale?

Dhe për një gjë fare, të paktën nisur nga fotografia. Aty thoshte plan i Fondit të Zhvillimit, të paktën nëpërmjet fotove dukej që ishin godina 6 katëshe, ndërsa në interesin që ka shfaqur bashkia Durrës tregohet që është, i datës 30 qeshor.2022-shit, tregohet që do jetë një godinë 5 katëshe me parkim nëntokësorë. Nuk jam shumë e qartë, nëse do më jepni një përgjigje. Faleminderit.

**Emiriana Sako**: Faleminderit shumë për pyetjen.

Ky është një projekt shumë i domosdoshëm për qytetin e Durrësit, nisur dhe nga rritja e trafikut në vitet e fundit, por më tepër gjatë sezonit turistik. Të gjitha pyetjet që Ju ngritët janë të përcjella në relacion në fakt, megjithatë unë po i them. Prona është e transferuar bashkisë së Durrësit. Nuk është e regjistruar, por “Ne” do të fillojmë procesin e regjistrimit. Është transferuar me VKM në vitin 2018.

Përsa i takon projektit të marinës është jashtë kufirit të zhvillimit projektit të marinës të Durrësit, por patjetër që “Ne” jemi konsultuar me Planin Rregullues të qytetit, pra është një zonë e cila ndodhet pranë stacionit të trenit është shumë e domosdoshme dhe shkon në një farë mënyre me një linjë se është një zonë transporti. Ata që do të përdorin stacionin e trenit do të kenë dhe një parkim publik në afërsi, vëtëm disa minuta nga stacioni i trenit, pra harmonizohet me këto projekte.

Sa i takon vlerës së investimit, Fondi Shqiptar i Zhvillimit është duke bërë projektin ekzekutiv, pra projektin e zbatimit. Ka mbaruar projekt-idea. Fondin “Ne” nuk e kemi sot, sepse nuk ka përfunduar projekt zbatimi, por investimi do të jetë tërësisht nga qeveria shqiptare. Pra, qyteti i Durrësit do të ketë një parkim që do të investohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe shfrytëzimi do të bëhet 50% me 50%. Pra “Ne” jemi në këtë rast pronar trull, investimi na vjen nga qeveria shqiptare. Do të ketë një plan biznesi më pas, pra kjo është një marrveshje parimore, draft, e cila me firmosjen e saj do të biem dakort me këto kushte që unë përmenda dhe më tej do të bëhet një plan biznesi i mirëfillt se si do të vendosen tarifat për përdorimin e parkimit, qoftë fitimet si do ndahen, qoftë dhe menaxhimi. Pra në marrëveshje shkruhet që menaxhimi do të ndahet në vite. Vitet e para do ta përdori Fondi Shqiptar i Zhvillimit, është caktuar në marrëveshje të paktën një katërvjeçar, pastaj nëse bashkia shpreh dhe ka aftësi ta menaxhojë ajo, patjetër do t’i kalojë bashkisë, sepse qasja është që të fuqizohen njësitë e qeverisjes vendore dhe menaxhimi patjetër që do t’i kalojë institucionit.

Ky nuk do jetë vetëm një parkim do të jetë një qendër, e cila do të ketë dhe teknologji brënda, do të ketë një zyrë për transportin, e cila do të merret dhe me problemet e tjera që ka qyteti i Durrësit sa i takon lëvizshmërisë. Dhe e vendosur në një pozicion të tillë shumë afër me qendrën do të bëjë të mundur që të pres dhe ato mjete, të cilat sot parkohen në rrugët kryesore të qytetit, të cilat në të ardhmen, parashikojmë në një të ardhme që mund të jenë pjesërisht të mbyllura ose 100% të mbyllura, si akset kryesore, si Bulevardi me zbatimin e projektit të amfiteatrit.

Ky projekt do të akomodojë rreth 400 poste parkimi, pra parimisht nga projekt-idea paraprake që kemi dhe besoj se brënda këtij viti do të kemi dhe fazat e tjera të investimit të saktësuara, pse jo të fillojë dhe investimi brënda vitit 2022. Faleminderit.

**Adriana Hatellari** : Faleminderit znj. Kryetare.

**Ani Dyrmishi** : Komente të tjera ka nga këshilltarët ?

Po, Artion.

**Artion Beqiraj**: U njoha me materialin, është shumë interesant dhe me shpjegimet që dha kryetarja. Sa i takon një saktësimi të vogël, mesa kam kuptuar unë është tek stacioni ri i trenit, jo tek i vjetri? Tek Ura e Durrësit.

**Emiriana Sako:** Vendi është paralel me rrugën e Portit. Është një hapsirë që sot parkohen rastësisht makinat aty, është një hapsirë publike. Kështu që në këtë territor “Ne” kemi gjetur mundësinë që ta zhvillojmë këtë projekt. Nuk kemi shkuar me kat nëntokë pasi ka kosto, rritet kosto, por meqënëse dhe Plani Rregullues e lejon ngritjen mbi tokë, atëherë ky do të jetë një objekt parkimi publik i përdorur për interes publik për qytetarët e Durrësit.

**Artion Beqiraj :** Kisha një pyetje : Aksesi do të jetë nga rruga e Portit apo do ketë akses dhe nga rruga Dajlanit, si është menduar?

**Emiriana Sako:** Është e detajuar në projekt. Mesa kam parë unë projektin hyrja do të jetë nga rruga kryesore ajo që është paralel me murin e Portit.

**Ani Dyrmishi :** Faleminderit.

Komente të tjera kemi? Nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 18?

Kundra?....

Abstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë me 36 vota pro miratohet dhe pika 18 e rendit ditës.

- **Përsa i përket pikës tjetër** “Informim i këshilltarëve”, pikë e cila është vendosur për tu marrë në shqyrtim sipas programit vjetor të punës së këshillit në mbështetje të VKB-së nr.148 datë 25.11.2021, i japim fjalën për një raportim për sezonin turistik në Durrës për vitin 2022 znj. Olta Dedej.

**Olta Dedej (përgjegjëse pranë Drejtorisë së Turizmit) :** Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Olta Dedej me detyrë përgjegjëse pranë Sektorit të Politikave të Turizmit, Drejtorja e Turizmit, bashkia Durrës.

Ashtu si jeni informuar besoj dhe me raportin që kemi dërguar pranë këshilli bashkiak për sezonin turistik Durrës, 2022 dua të them që në përgjithësi është parë një rritje në radhë të parë si në numrin e vizitorëve në portin e Durrësit, ashtu dhe në numrin e jahteve dhe kroçerave në një rritje me 20 %, le të themi.

Fluksi i turistëve në portin e Durrësit për 8 mujorin e parë të vitit paraqitet si më poshtë:

- ✓ Hyrjet në portin e Durrësit: rritje me 16% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021
- ✓ Numri i jahteve dhe kroçerave në portin e Durrësit: rritje me 8% kroçera, dhe 23% jahtet
- ✓ Numri i vizitorëve në Muze dhe Amfiteatër: rritje me 24.5%.

Në kuadër të çeljes së sezonit turistik veror 2022, sikurse çdo vit, janë marrë masat e duhura për të siguruar dhe garantuar:

- Ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në përputhje me marrjen e masave anti COVID-19;
- Sigurinë në det dhe në plazhe në përputhje me marrjen e masave anti COVID-19;
- Furnizimin me ujë të pijshëm;
- Mirëmbajtjen dhe pastrimin e territorit të Bashkisë, duke respektuar masat anti COVID-19;



- Zbatimin e ligjit për hapësirat publike në veçanti të plazheve private;
- Promovimin e atraksioneve/destinacioneve turistike.

- **Mirëmbajtja dhe pastrimi i territorit të Bashkisë**

Bashkia Durrës ka gurin e themelit të zhvillimit ekonomik, turizmin 365 ditor. Bashkia Durrës punon në vazhdimësi për një qytet më të pastër, një qytet më të ndriçuar dhe më të gjelbër.

- **Pastrimi**

Janë ndërmarrë aksione në zona të ndryshme të qytetit, kryesisht ato periferike ku bëhej një depozitim i jashtëligjshëm dhe gjendeshin vatra mbetjesh urbane e ndërtimore depozituara nga banorët, apo subjekte te ndryshme. Janë pastruar zonat e :

- ✓ Gjirit të Lalzit;
- ✓ Parku natyror me pisha, në Sektorin Rinia në Katundin e Ri;
- ✓ Grykëderdhja e lumit Ishëm, ku fatqësisht janë shkarkuar në det prej vitesh mbetje plastike apo qelqi
- ✓ Monumenteve të ndryshme kulturore si: Kepi i Rodonit dhe Kalaja e Ishmit.

Bashkia Durrës, si nivel i qeverisjes vendore është e vendosur që ta çojë deri në fund këtë nismë. Kështu, falë master-planit të menaxhuar të mbetjeve, ne sot në Durrës, nuk depozitojmë me mbetje urbane dhe në vend të ish fushës së mbetjeve të Porto Romanos, sot kemi nje park atraktiv prej 15 ha ku janë ndërtuar fusha sportive të disiplinave të ndryshme si fusha basketbolli, volejbolli, minifutbolli, tenisi. Gjithashtu, janë mbjellë me mijëra peme dhe është ndërtuar *Climbing - Wall*, i cili është një ndër muret më të larta në ballkan. Eco-Parku është rasti unik në Shqipëri dhe në Ballkan.

Me qëllim garantimin e pastrimit të të gjithë territorit të Bashkisë së Durrësit për sezonin e ri turistik veror dhe jo vetëm, motoja jonë ka qenë *“pa pastrim, nuk mund të kemi turizëm”*. Ndaj, fokusi ynë kryesor mbetet pastrimi i të gjithë tërritorit, për t’i ofruar të gjithë qytetarëve dhe pushuesve një ambient sa më të pastër dhe sa më të shëndetshëm.

Kështu, disa nga masat kryesore lidhur me pastrimin e territorit për sezonin e ri turistik janë:

- Është kryer pastrimi i zonës bregdetare nga leshteriku (Plazhi i madh dhe Currila);
- Është pastruar e gjithë zona pyjore në Hamallaj, Gjiri i Lalzit dhe Ishëm (njëkohësisht dhe vija bregdetare e plazheve);
- Është kryer dhe vazhdon të kryhet rregullisht dizifektimi i shesheve dhe vendeve publike (si shëtitore, lulishte etj)

Në lidhje me sezonin veror janë marrë masat e duhura:

- ✓ pastrimi i të gjithë bregdetit është puna jonë e përditshme,
- ✓ gjatë sezonit ka pasur shtimin e punonjësve të ndërmarrjeve tona të pastrimit me punëtorë sezonalë,
- ✓ janë nënshkruar marërveshjen e bashkëpunimit me AKB-në për të shtuar shërbimin e pastrimit dhe evadimin e mbetjeve.

- **Gjelbërimi**

Ndërsa, përsa i përket gjelbërimit të qytetit, janë marrë masa për shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta. Kështu, deri tani janë mbjellur mbi 320 pemë në zona të ndryshme të qytetit. Gjithashtu, janë planifikuar të mbillen rreth 505 bimë/lule dekorative në të gjithë territorin e Bashkisë. Kanë përfunduar procedurat e tenderimit edhe për 3 mijë pemë të tjera konkretisht:

- ✓ Manjollë , Bli ,Geshtenjë, Kumbull e kuqe , Rrap .

- **Investimet**

Investimet kryesore janë kryer në:

- ✓ Ndriçimin e akseve të ndryshme në zonen e Plazhit;
- ✓ Blerjen e koshave për depozitimin e mbetjeve urbane, duke plotësuar fillimisht nevojat e zonave turistike konkretisht ;
- ✓ Ndërrimin e plotë të flotës së mjeteve për pastrimin e qytetit, është tenderuar deri tani blerja e 7 mjeteve të reja për evadimin e mbetjeve.
- ✓ Durrësi sot:
- ✓ Nuk ka me derdhje të ujerave të zeza në det,
- ✓ Ka zgjidhur problematikën e ujit të pijshëm në zonen e Shkëmbit të Kavajës dhe zonën e plazhit.

Nga ana tjetër nëpërmjet FSHZH:

- ka filluar nga puna në 13 rrugë në qytet ndër të cilat 5 janë me impakt direkt në zonën e plazhit: Kuartalli Qaf Bot, Rruga tek Rrota e Kuqe, Rr. Dhimiter Kraja, Rr.Danua, Rr.Prokop Gjergo.
- Ka filluar zbatimin e ndërhyrjes në rrugët dytësore paralele me autostradën Plepa – Kavajë ku përfshihet, infrastrukture tokësore, trotuare dhe ndriçim.

Bashkia Durrës ka filluar punën, për projektin më të nevojshëm, jo vetëm për zonën e plazhit frekuentuesit e saj por edhe për turistët dhe banorët. Aktualisht ka përfunduar fazën e hartimit të projektit për ndërtimin e shëtitorës së plazhit Durrës, e cila do të shtrihet nga Ura e Dajlanit deri në godinën e Kavalishencës.

Durrësi ka hapur një kapitull të ri në zhvillimin dhe transformimin e tij. Projekte madhore do t'i japin atij rolin që ka mbajtur në antikitet:

Projekti i MARINËS TURISTIKE: Ndërtimi i Marinës së Durrësit do të kthejë qytetin si një nga destinacionet turistike, ekonomike, nga më të rëndësishmit në Mesdhe, dhe do të ndikojë jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Durrësit por edhe në drejtim të fuqizimit të sektorit të turizmit.

Projekti i transferimit të PORTIT TREGTAR në Porto Romano.

Projekti i zbulimit të AMFITEATRIT: Projekti i menaxhimit të integruar të zonës arkeologjike-AADF do të bëjë të mundur zbulimin e plotë të Amfiteatrit të Durrësit dhe të vlerave të tij.

Muzeu Arkeologjik, Torra Veneziane e shumë monumente të tjera të cilat janë në fazën e rivitalizimit dhe transformimit të tyre, nëpërmjet arritjeve të fundit të teknologjisë do të kthehen në pika kyçe të turizmit në qytet.

- ***Siguria në det dhe në plazhe:***

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore” si edhe VKM-së Nr. 1172, datë 24.12.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 171, datë 27.03.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar, janë marrë masat e nevojshme për ndarjen me % të sipërfaqeve/hapësirave publike dhe private sikurse kërkuar.

Hapësira e lënë për plazhe publike është e shtrirë në mënyrë proporcionale në të gjithë vijën bregdetare. Sipërfaqja totale e stacioneve të plazhit është 1,191,102 m<sup>2</sup> nga të cilat 523,996 m<sup>2</sup> janë plazhe publike. Gjithashtu, me qëllim garantimin e sigurisë, edhe gjatë këtij sezoni turistik janë realizuar inspektime të përditshme nga grupet e punës në terren të cilat veprojnë në bashkëpunim me policinë bashkiake dhe policinë e shtetit.

Për sa më sipër, me objektivin kryesor strategjik rritjen e fluksit të vizitorëve në qytetin e Durrësit, dhe duke konsideruar zhvillimin e turizmit cilësor si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik vendor, turizmi në Durrës duhet të orientohet gjithnjë e më shumë drejt ndërlidhjes së sektorëve të shërbimeve/produkteve të turizmit bregdetar, kulturor, dhe historik.

Kështu, Bashkia Durrës synon të mbështesë realisht të gjithë bizneset që operojnë në sektorin e turizmit, duke i nxitur akoma edhe me shumë këta të fundit të ofrojnë shërbime apo produkte turistike cilësore, të cilat përkthehen në rritjen e ekonomisë lokale.

Numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet “Hoteleri” brenda territorit të Bashkisë Durrës sipas të dhënave të DTTV është 204 hotele, në 6-mujorin e parë të vitit 2022, nga 158 hotele që kanë qenë në vitin 2021. Aktualisht grupi i punës, Task Forcë po realizon verifikimet në terren, për saktësimin e numrit të dhomave dhe shtretërve.

- ***Ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike***

Në kuadër të çelejs së sezonit turistik veror për vitin 2022, policia Bashkiake ka marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, më konkretisht në lirimimin e hapësirave publike si edhe respektimin e orareve të muzikës së lejuar në lokalet e zonës së plazhit si edhe në qytet, në përputhje kjo edhe me masat anti COVID-1

- ***Furnizimi me ujë të pijshëm:***

Gjatë këtij sezoni veror, nga Ndërnarrja e Ujësjellës Kanalizimeve, janë marrë masat për të siguruar sasinë e nevojshme të ujit dhe për të realizuar furnizim me ujë të pijshëm për të gjitha zonat e qytetit.

Nga ana e Repartit të Mirëmbajtjes gjatë sezonit turistik, një vëmendje të veçantë i është kushtuar zonave turistike, duke iu përgjigjur në kohë çdo problematike në lidhje me difektet në linjat e furnizimit me ujë apo dhe zbllokimet në rrjetin e kanalizimeve.

- **Promovimi i atraksioneve/destinacioneve turistike:**

Gjithashtu, në kuadër të çeljes së sezonit turistik veror, janë organizuar një sërë aktivitetesh kulturore, sportive dhe artistike me përfshirjen më së shumti të të rinjve të qytetit, me qëllimin krijimin e një atmosfere festive dhe mikpritëse për të gjithë turistët vendas dhe të huaj.

Janë organizuar në total 55 aktivitete për periudhën Maj- Shtator, rreth 11 aktivitete në muaj.

Aktivitete të tilla si:

- ✓ Java e turizmit, Street Fest,
- ✓ Festivali Veror i Librit,
- ✓ Basketball 3x3,
- ✓ Moto Fest,
- ✓ Festivali Veror i Filmit,
- ✓ Ekspozita të artistëve të ndryshëm në galerinë “Nikolet Vasia”,
- ✓ Aktivitete artistike në pallatin e kulturës “Aleksander Moisiu”,
- ✓ Java Europiane e Lëvizshmërisë, etj

I kanë shtuar gjallërinë e qytetit duke u kthyer në një burim argëtimi për turistët vendas e të huaj.

Në kuadër të promovimit të potenciale turistike të qytetit, janë realizuar një sërë fushatash apo aktivitetesh promocionale me fokus trashëgiminë kulturore, atraksionet/destinacionet turistike përfshirë këtu dhe shtigjet natyrore, këtë vit është eksploruar shtegu natyror në kodrat e Ishmit-Shetaj.

Këto fushata promovuese shërbejnë si një promotor i mbrojtjes dhe ruajtjes së burimeve dhe vlerave të pazëvendësueshme kulturore, turistike dhe natyrore të qytetit.

Bashkia Durrës tashmë ka një fokus të veçantë për të pasuruar turizmin edhe me ofrimin e një produkti tjetër turistik: arkeologjinë nënujore. Zbulimet e fundit arkeologjike të bëra në zonën e Kepit të Rodonit dhe në plazhin e Currilave, në kuadër të projektit APRODI PLUS, synojnë të diversifikojnë guidat turistike të qytetit në sajë të kombinimit tokë dhe det, duke u mundësuar kështu vizitorëve diçka ndryshe nga e kaluara. Gjetjet e këtyre zbulimeve së shpejti do të jenë të ekspozuara në pavionin e arkeologjisë nënujore, pranë Muzeut Arkeologjik Kombëtar, Durrës.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Ka pyetje nga këshilltarët?

**Artion Beqiraj :** Atëherë pyetja jonë nga Komisioni i Turizmit, faleminderit për informimin, një mendim do të jepja që duke qënë në kuadër të raportimit, të jetë e organizuar dhe në problematika që dalin se është normale, se nuk është ndonjë gjë se del një problem dhe çfarë zgjidhje jepet. Dhe përsa i përket numrit të pushuesve, sepse ai është një tregues i rëndësishëm, po të jetë krahasimor me vitin e shkuar sa net fjetën më shumë në Durrës. Kjo për mendimin tim përshëmbull arrihet duke u lidhur në rrjet me agjencitë turistike në qytet, sepse ato janë motorët, nëse nuk lëvizin ata, pra të ndërtohet një rrjet dhe shpërndahet informacioni, ky i shërben dhe punës që bën bashkia pastaj që shkon dhe për infrastrukturën dhe turizmin. Këtë kisha për raportin.

**Olta Dedej :** Në rregull, do të reflektohen në informimet e tjera.

**Artion Beqiraj :** Unë kam dhe diskutim tjetër që mund të jetë i hapur pastaj, sepse Durrësi tashmë po shtohet me Porte. Është një qytet i nisur me një port, është me 3 se do shtohet dhe një tjetër. A duhet të fillojmë të mendojmë që qyteti vet të përfitoj të ardhura nga ky aktivitet, pra jo thjesht taksimi i pasurisë, pra jo thjesht taksime që vinë , por të ketë të ardhura pikërisht nga aktiviteti që bëhen . Natyrisht që këtu ka implikime sepse taksat caktohen me ligj etj, etj..por të reagojë porti i Durrësit si Port shtetëror, do vi një subjekt privat, shumë mirë që vjen, por do ketë statusin e investitorit strategjik, por do ketë përjashtime nga disa taksa e tarifa mbase, pra do jenë disa të ardhura të munguara. Mund të mendojmë përshëmbull që të bëhet një nisëm të propozohet ndryshim në ligj, ku të vendoset një % -je sa do të jetë ajo në xhiron që bëjnë këto subjekte, pra mos të merremi pse hyri turisti ta taksojmë, pse hyri anija ta taksojmë, se duket pse vinë hajt të vendosim taksë, por në bazë të gjenerimit , sepse përveç të mirave ato sjellin pastaj dhe flukse ka ndotje, ka dëmtime etj, etj..por duhet të vi dhe kontribut. Duke qënë se qyteti ofron gjithë këtë vijë bregdetare të kemi një kontribut. Unë vet do e shikoja në këtë aspekt, nuk ka kompetencë të plotë këshilli që ta vendosi pasi do të ishte e çalë , por mund të ishte një propozim për ndërhyrje në ligj në nivel kombëtarë, por nga xhiro e këtyre subjekteve portuale një %-je sado të jetë t'i shkoj qytetit dhe ajo pastaj të shpërndahet si fond për turizmin, për vepra që i shërbejnë. Kaq kisha. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit z. Beqiraj.  
z. Xhangoli.

**Kastriot Xhangoli :** Në lidhje me këtë pjesë unë doja të pyesja : A kemi “Ne” kioska informacioni për turistët?

**Olta Dedej :** Akoma jo nuk kemi. Nuk është akoma shërbimi i kioskave, domethënë ka qënë, por për momentin nuk funksionon, shpesojmë që do të kthehen për informacion kioskat për qytetin.

**Emiriana Sako:** Kioska për turizmin, sot informacioni është tërësisht elektronik, pra dhe shpërndarja e hartave në letër në pika të caktuara të qytetit është një gjë, që në njëfarë mënyre i ka ikur koha. Dhe njerëzit sot kushdo që vjen nga jashtë arrijnë të aksesoj nëpërmjet internetit aplikacione të ndryshme për vëndet që do të vizitojë apo për njohjen e qytetit.

Kemi në plan për vitin që vjen të realizojmë një tip aplikacioni ku do të prezantohen ose do të ketë një lidhje midis pikave të interesit, vendet për tu vizituar, monumentet arkeologjike, por edhe restorante dhe hotele që ka Durrësi. Nga ana tjetër Torra Veneziane, që është në përfundim të punës të rehabilitimit të saj me fondet e youth 4culture në përfundim të saj do të shërbej si infopront i mirëfillt ku do të jepet informacion për turistët, do ketë një akses shumë të mirë e do të jetë apo do të bëhet mundësimi i kësaj që Ju kërkoni. Sigurisht në formate digitale dhe i aksesueshëm në të gjitha grupmoshat. Është një projekt i Ministrisë së Kulturës, besoj se brënda vitit do të bëhet përfundimi i rehabilitimit të objektit dhe më tej do të bëhet strukturimi dhe vendosja e këtij aplikacioni dhe personave që do të punësohen atje dhe do të bëjnë pikërisht këtë proces pune për informimin e vizitorëve dhe turistëve të qytetit të Durrësit përsa i takon asetëve tona turistike.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit Kryetare.

Pyetje të tjera s'kemi.

Atëherë faleminderit të gjithëve, faleminderit Kryetare.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga sekretaria e këshillit.

*Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 22 (njëzet e dy) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.*

**Mbajtësi i procesverbalit:** Dorina Milja

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Këshilltar i Grupit të Pavarur të KB :

FLUTURA KASA